

BULETINI INFORMATIV

SHTATOR

2025



Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit shtator

Gjatë muajit shtator 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar katër mbledhje vendimmarrëse. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 44 vendime që synojnë zhvillimin e mëtejshëm të tregut të energjisë në vend.

Licencime të reja

Bordi i ERE-s ka vendosur miratimin e kërkesave për licencim të shoqërive:

“GREEN VALUE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

“AMEL ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Bashkinë Fier, Qarku Fier, për një afat 30 vjeçar.

“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 12 MW, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Qarku Kukës, për një afat 25-vjeçar si dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

Të dy centralët e mësipërme pritet të hyjnë në funksion deri më 31 dhjetor 2025, duke sjellë një shtesë të rëndësishme prej 14 MW në kapacitetin e instaluar të vendit. Me vënien në punë të tyre, pritet të zgjerohet më tej burimi i prodhimit vendas të energjisë dhe të forcohet diversifikimi i portofolit energjetik kombëtar.

Autorizime për garanci financiare

Bordi i ERE-s miratoi kërkesat në lidhje me marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërive:

“Diezela” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 16, Datë 23.01.2020 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar.

“NRG POWER” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 199, Datë 03.08.2022 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

Procedura licencimi të filluara gjatë muajit shtator

Gjatë muajit shtator, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurat për licencimin e shoqërive:

“Nikolica Ski Resort” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Orikum, Qarku Vlorë;

“Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 MW, me vendndodhje në Spitallë, Qarku Durrës.

“GREEN VALUE” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike;

“GSA ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë;

“VIVID POWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë

“REYTECH TRADING” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar. ERE për të gjitha këto aplikime ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

BULETINI INFORMATIV

SHTATOR

2025



Publikime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit shtator është përditësuar web i ERE dhe rrjetet sociale me [vendime](#), [njoftime të mbledhjeve](#), [njoftime mbi aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorit ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))

Regjistri REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021 si dhe Ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka publikuar të dhënat mbi regjistrimin e Pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Ky regjistër, gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen e ERE-s në linkun <https://ere.gov.al/sq/tregu-i-energji/remit>. Gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar tre shoqëri.

Vendime të tjera

U miratuan disa ndryshime në vendimet e Bordit të ERE-s Nr. 160/2025 dhe Nr. 148/2025 mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesat e shoqërive “**IDI 2005**” sh.p.k dhe “**SUNPRO**” sh.p.k., deri në depozitimin nga ana e shoqërive të dokumentacionit të domosdoshëm bazuar në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

U miratuan ndryshimet në vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 142, datë 07.07.2025, për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë “**ARIS ALBANIA**” sh.p.k si rezultat i ndryshimeve të kushteve të paravendosura në vendimmarrje.

U miratuan disa ndryshimeve në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s, për licensimin e shoqërive “**SPV BLUE 2**” shpk, “**MER ENERGJI**” shpk dhe “**SUNNY SIDE ENERGY**” shpk si rezultat i plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Si dhe u miratuan disa ndryshimeve në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s për licensimin e subjekteve “**MP-HEC**” shpk, “**ELVA 2001**” shpk, “**ERA HYDRO**”shpk, “**GEGA-G**”shpk, “**DERBI-E**” shpk, “**KALISI HYDROPOWER**” shpk, “**IDI 2005**” shpk, “**ERDY ENERGY**” shpk, “**GREENTECH ENERGY SYSTEMS**” shpk , “**AGETA**” shpk, “**ARIS ALBANIA**”shpk, “**REI - ENERGJI**” shpk, “**GERTI**” shpk, “**VOKOPOLA ENERGJI**” shpk, “**EGNATIA HYDROPOWER**” shpk, “**RTS**” shpk, “**NTSP**” shpk, “**KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK**” shpk, “**TREN SUN SYSTEM**” shpk, “**SUN BEAT SYSTEM**” shpk, “**GREEN ENERGY BILISHT**” shpk dhe “**TIRANA ENERGJI**” shpk, që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke vendosur heqjen e kushteve që lidhen me dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat

ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licensuar. Heqja e kushteve, nuk përjashton këto shoqëri nga detyrimet që të ruajnë në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licensuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.

BULETINI INFORMATIV

Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 9 shtator 2025, Bordi i ERE miratoi **çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, në vlerën 14.70 Lekë/kWh.**

Ky çmim është më i ulët krahasuar me muajin korrik 2025, i cili ishte 16.06 lekë/kWhlekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, koston e rrjetit dhe koston administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatje është kostoja e energjisë së blerë.

Për muajin gusht 2025, kostoja mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar 10.92 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 172.22 MWh. Ndërkohë, për muajin korrik 2025, kostoja përkatëse ka qenë 12.23 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 147.77 MWh. Në terma krahasues, kostoja e blerjes së energjisë për muajin gusht është ulur me rreth 12% në raport me korrikun, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV është rritur me 16.54%.

Si rezultat, çmimi i shitjes së energjisë për muajin gusht (14.7 lekë/kWh) rezultoi më i ulët krahasuar me atë të korrikut (16.06 lekë/kWh), kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të energjisë në tregun e lirë, të cilat ndikohet nga dinamika e kërkesës dhe ofertës në treg.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar, në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Të dhënat e tregut të energjisë për 8-mujorin e vitit 2025

Në faqen zyrtare të ERE-s do të gjeni gjithashtu të dhënat e tregut të energjisë për 8-mujorin e vitit 2025, ku reflektohet që sasia e energjisë së prodhuar total ka qenë **4,720,280 MWh**, sasia e energjisë së konsumuar ka qenë **5,544,994 MWh** dhe sasia e energjisë së blerë në treg të lirë sipas detyrimit për shërbim publik nga KESH sh.a. gjatë 8 mujorit të 2025 ka qenë **1,235,335 MWh**. Pwr sa i pwrket nivelit tw humbjeve, Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes për 8 mujorin e 2025 arrijnë në 16.60%, duke shënuar një **ulje të nivelit të humbjeve me rreth 1%** krahasuar me te njejtën periudhë të vitit 2024. Humbjet e përgjithshme të sistemit të transmetimit për 8 mujorin e 2025 arrijnë 1.90 % duke ulur nivelin e humbjeve me rreth 0,14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Përsa i përket muajit Gusht 2025 niveli i disbalancave pozitive (kosto për OST) përlllogariten 29,166 MWh ndërsa niveli i disbalancave negative (kosto për PBB) përlllogariten 19,955 MWh. Gjatë 8 mujorit të 2025 kanë hyrë në operim 6 centrale hidrike dhe 5 centrale fotovoltaike. Kapaciteti i instaluar per centralaet hidrike përlllogaritet **69.23 MW** ndërkohë per centralet fotovoltaike **155.98 MW** si dhe janë 9 hece të cilët kanë zotëruar kontratë shit-blerje me FTL sh.a dhe tashmë operojnë në treg të lirë me nje kapacitet total të instaluar prej **26.37 MW**.

Të plotë këtë raport mund ta gjeni në linkun <https://ere.gov.al/sq/tregu-i-energji/raporte-dhe-te-dhena-te-tregut-te-energji-e-elektrike>

Seanca dëgjimore

Gjatë muajit shtator, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), si dhe me Zyrtarin e Pajtueshmërisë së shoqërisë ALBGAS sh.a.

Këto takime u mbajtën në ambientet e ERE-së dhe kishin si qëllim kryesor shkëmbimin e mendimeve, diskutimin konstruktiv dhe sqarimin e çështjeve të rëndësishme që lidhen meraportimet periodike, si dhe me detaje të tjera që ndihmojnë në përmirësimin e transparencës dhe zbatimin e kuadrit rregullator.

Gjatë këtyre takimeve, palët patën mundësinë të thellohen në analizën e praktikave aktuale, të identifikojnë sfidat e evidentuara gjatë zbatimit të detyrimeve ligjore dhe rregullatore, si dhe të propozojnë mënyra bashkëpunimi për përmirësimin e proceseve të raportimit dhe monitorimit.

ERE vlerëson angazhimin dhe bashkëpunimin e institucioneve në fjalë, duke theksuar rëndësinë e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet operatorëve të tregut të energjisë dhe autoritetit rregullator, me synimin për të garantuar një sistem energjetik më efikas, transparent dhe në përputhje me standardet më të mira të qeverisjes korporative.